



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. i faq. Brej. stranic Nr. pages	02+02
Nr. Prot Br. Prot Prot. No	06-3272/19
Data Datum Date	11-12-2019
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 10.12.2019, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-01/19/030*, për zyrtarin e lartë publik z. Siniša Borisavljevic, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Borisavljevic, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi që është identifikuar se zyrtari i lartë publik z. Borisavljevic, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, njëkohësisht është edhe person i autorizuar në biznesin privat "Siniša Borisavljevic" B.I.

Agjencia kundër Korrupsionit (në vijim: Agjencia), me qëllim të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesit ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), informata për biznesin në fjalë (shkresa zyrtare DPKI-06-2380/19). Nga informatat për biznesin të pranuar nga ARBK (DPKI-06-2380-1/19), është konstatuar se zyrtari i lartë z. Borisavljevic, është person i autorizuar në biznesin e sipërshtënuar.



Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-06-2528/19 të datës 22.10.2019, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet gjendje të konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Zyrtari i lartë z. Borisavljevic, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka deklaruar se brenda afatit do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmangë gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, më datë 05.12.2019, Agjencia ka pranuar shkresën (DPKI-06-3204/19) me të cilën dëshkohet se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet në biznes.

Pas analizimit të informatave mbi biznesin, Agjencia konstatoi se zyrtari i lartë z. Borisavljevic, ka transferuar të drejtat e drejtimit të biznesit private tek personi i besuar sikurse parashihet me nenin 15 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.


Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.


II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Na osnovu člana 5., stav 1. podstav 1.5. člana 18., stav 10. i 11. Zakona br. 03/L-159 o Agenciji protiv korupcije, kao i člana 7., stav 4. Uredbe br. 01/2018 o izmeni i dopuni Uredbe br. 01/2014 i Uredbe br. 01/2017, rada Agencije za borbu protiv korupcije, Direktor agencije protiv korupcije je dana 10.12.2019, doneo:

ODLUKU

- I. **Zatvara se slučaj sa br. *AKK-DPKI-01/19/030*, za višeg javnog službenika g. Siniša Borisavljević, Sudija u Osnovnom sudu u Prištini, iz razloga što je otklonjeno stanje sukoba interesa u vršenju javne funkcije.**
- II. **Slučaj se može ponovno otvoriti u svakom vremenu kada se budu pojavili novi okolnosti.**

O b r a z l o ž e n j e

I. Slučaj je pokrenut zbog sumnje o sukobu interesa u vršenju javne funkcije za višeg javnog službenika g. Borisavljević je tretiran prema proceduri predviđenoj Zakonom br. 06/L-011 o sprečavanju sukoba interesa pri vršenju javne funkcije.

Ovaj slučaj se počeo tretirati nakon što je identifikovano da je g. Borisavljević, sudija Osnovnog suda u Prištini, istovremeno je ovlašćeno lice u privatnom biznisu „Siniša Borisavljević“ P. B.

Agencija protiv korupcije (u daljem tekstu: Agencija) je radi verifikacije stanja sukoba interesa tražila od Kosovska agencije za registraciju biznisa (KARB) informacije o predmetnom biznisu (službeni dopis DPKI/DSSI-06-2380/19). Iz informacija o biznisu dobijenih od KARB (DPKI/DSSI-06-2380-1/19) zaključeno je da je viši službenik g. Borisavljević ovlašćeno lice u gore navedenom biznisu.



Agencija je Službenim dopisom DPKI/DSSI-06-2528/19 od 22.10.2019, godine obavestila višeg službenika o pokretanju postupka razmatranja stanja sukoba interesa.

Viši službenik tokom vršenja javne funkcije ne može biti ovlašćeno lice u privatnom biznisu, jer takva situacija predstavlja stanje sukoba interesa, odnosno nespojivost sa vršenjem javne funkcije. Ovo je zabranjeno odredbom člana 13. stav 1. Zakona o sprečavanju sukoba interesa pri vršenju javne funkcije, koji predviđa da:

“Visoki zvaničnik ne može da bude menadžer, punomoćnik niti član bilo kog organa upravljanja ili nadzora u privatnom pravnom licu, bilo da je profitno ili neprofitno, izuzev političkih subjekata, subjekata propisanih u članu 14 ovog zakona, kao i u slučajevima kada je takva funkcija zakonom namenjena po osnovu funkcije.”

Viši službenik g. Borisavljević se složio sa nalazima Agencije i izjavio da će preduzeti mere u roku da izbegne situaciju sukoba interesa.

U međuvremenu, 05.12.2019. godine, Agencija je primila dopis (DPKI/DSSI-06-3204/19) u kojem se dokazuje da je viši službenik izvršio promene u biznisu.

Nakon analize informacija o biznisu, Agencija je utvrdila da je viši službenik g. Borisavljević preneo prava vođenja privatnog biznisa na poverenu osobu kako se zahteva članom 15. Zakona o sprečavanju sukoba interesa pri vršenju javne funkcije. Postupcima koje je viši službenik preduzeo izbeglo se stanje sukoba interesa u vršenju javne funkcije.

Kao što je gore navedeno, odlučeno je kao u tački I izreke ove odluke.

II. Na osnovu člana 18. stav 11. Zakona br. 03/L-159 o Agenciji protiv korupcije, Agencija može ponovo otvoriti slučaj u bilo kojem vremenu ako se pojave nove okolnosti.

Odluka se dostavlja:

- Višem javnom službeniku
- Direktor DSSI- a
- G./gđi. (odgovornom službeniku)

Shaip Havoŕi
Direktor Agencije protiv korupcije

